Situata A për shkrimin e tekstit argumentues

Në shkollë diskutohet rregullorja e brendshme para se të miratohet dhe të hyjë në fuqi. Një nga nenet që ka hapur një debat të gjerë është ai që ndalon kategorikisht përdorimin e telefonit celular në mjediset e shkollës. Nxënësit kanë mendime të ndryshme, deri të kundërta për miratimin e këtij neni. Disa e shohin si shkelje të drejtash dhe kanë argumentet e tyre për këtë (nevoja familjare, urgjenca etj.). Të tjerë, përkundrazi, e shohin celularin si pajisje të tepërt e të panevojshme dhe nenin përkatës si të nevojshëm për vendosjen e rregullit dhe qetësisë në orët e mësimit.

Kompetencat	Teza	Antiteza	3 argumente	2 k/argumente	Struktura
Nota/Pikët	10 pikë	10 pikë	30 pikë	40 pikë	10 pikë

Kërkesa:

- **Shkruani një ese argumentuese që të përmbajë një tezë, një antitezë, tri argumente dhe dy kundërargumente.**
- **Organizoni tekstin në një strukturë klasike Hyrje – Zhvillim – Mbyllje.**